

## **STATUTI I SHOQËRISË dhe AKT THEMELIMI**

### **“ALBCOMPRT” SHPK**

Sot me date 15/03/2018, ne perputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";

Z. Richard John Baxter, lindur me **06.07.1965** ne Angli , madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar , mbajtes i pashaportes me nr 801591622

Z. Alban Bala, e lindur me **24.05.1970** ne Tirane, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar,

Zj. Adriana Duraj e lindur me **25.02.1971** ne Tirane, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar,

Themelojne ne cilesine e Ortakeve te Shoqerise, Shoqerine me perjegjesi te kufizuar **“ALBCOMPRT” SHPK** me permajtjen si me poshte vijon:

### **KAPITULLI I**

#### **FORMA; KOHËZGJATJA; ZYRA QENDRORE; OBJEKTI**

##### **Neni 1: Forma Juridike**

Shoqeria **“ALBCOMPRT” SHPK** eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga personat fizik te siperpermendur, te cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

##### **Neni 2: Kohezgjatja**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pakufizuar qe fillon prej dates se regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendres Kombetare te Biznesit (me poshte referuar si QKB).

Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të pezulloje ose mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

##### **Neni 3: Zyra Qendrore**

Zyra Qendrore e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Njesia Bashkiake nr. 10, Rruga Mujo Ulqinaku , Pallati 7, Hyrja7/53, Tirane.**

Gjate ushtrimit aktivitetit te saj, shoqeria mund te hape dege ose zyra perfaqesimi si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

#### **Neni 4: Objekti**

Shoqeria do te kete per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

- a) Sherbime Biznesi
- b) Konsulence Financiare dhe Fiskale

-Gjithashtu, per te realizuar objektivat e saj, shoqeria mund te ndermarre e te zhvilloje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter te ligjshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme.

- Objekti i shoqerise mund te zgjerohet apo zvogelohet ne varesi te interesave te shoqerise dhe ne baze te vendimit te asamblese se per gjithshme te ortakeve.

#### **KAPITULLI II** **KAPITALI**

##### **Neni 5 : Kapitali themeltar**

5.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë i formuar ne mase te plete nga kontributi i ortakut dhe i ndare ne kuote me vlere nominale sipas ndarjes se meposhtme. Cdo kuote njesie ka te drejten e nje vote. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij si me poshte:

Ortaket :

Z. Richard John Baxter, zoterues i nje kuote me vlere te per gjithshme 90.000 (nentedhjet mijë)leke, qe perben 90% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Alban Bala, zoterues i nje kuote me vlere te per gjithshme 5.000 (pesë mijë)leke, qe perben 5% te kapitalit themeltar te shoqerise

Zj. Adriana Duraj, zoteruese e nje kuote me vlere te per gjithshme 5.000 (pesë mijë)leke, qe perben 5% te kapitalit themeltar te shoqerise

#### **KAPITULLI III** **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

##### **Neni 6**

##### **Organet kryesore drejtuese te shoqerise jane:**

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve
- Administratori

##### **Neni 7**

##### **Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve Te drejtat dhe detyrimet**

7.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

7.2. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji

7.3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i tretti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## Neni 8

### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve

8.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë drejtar ortakeve te shoqerise. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

8.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 10.1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 9

### Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.

c) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 10

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

ç) përcaktimin e shpërblimeve

d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## Neni 11

### Administrimi

11.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, te cilet duhet te jene detyrimisht ortake te saj. Afati i emëritit te administratorit regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

11.2. Administrator i pare i shoqerise eshte Z. **Alban Bala e cila zgjidhet per një periudhe 5 vjecare.**

11.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoret në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## Neni 12

### Kompetencat e administratoreve

*Administratoret kane të drejtë e detyrohen të:*

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e seurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare e Biznesit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

#### **Neni 13**

#### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor nen juridikacionin e se cilit shtrihet aktiviteti i shoqerise.

#### **Neni 14**

#### **Largimi i ortakut**

Ky statut nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun ne baze te dispozitave perkatese te legjislacionit tregtar ne fuqi.

#### **Neni 15**


#### **Dispozita perfundimtare**

Ne cdo rast, palet do ti referohen dispozitave ligjore te ligjit 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per zgjidhjen e ceshtjeve konkrete dhe te detajuara te cilat nuk jane permendur specifiksht ne kete akt themelimi personi juridik.

Ky statut u redaktua ne 3 ekzemlare me permbytje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi u miratua ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem i Shoqerise, u nenshkrua rregullisht nga ai pa asnjë verejtje.

#### **ORTAKET E SHOQERISE**

RICHARD JOHN BAXTER



ALBAN BALA



ADRIANA DURAJ

